



Anketa mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë

Vala e dytë

Përmbledhje e gjetjeve për qarkun e Kukësit

SHTATOR 2022

Autorë: [Deanna Davy](#), Konsulente ndërkombëtare për UNICEF Shqipëri
[Blerina Metanji](#), IDRA Shqipëri

Drejtues i Studimit: [Elda Denaj](#), Specialistja e Monitorimit të të Drejtave të Fëmijëve dhe Vlerësimit në UNICEF Shqipëri

Editor: [Iain Wilson](#)

Ky dokument është përgatitur në kuadër të programit *Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria*, zbatuar nga një koalicion i gjashtë organizatave ndërkombëtare dhe kombëtare: UNICEF Shqipëri, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë/Prezenca në Shqipëri, Terre des Hommes, Tjetër Vizion, Vatra dhe Të Ndryshëm dhe të Barabartë. Programi financohet nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar (MB).

Pikëpamjet e shprehura në raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet zyrtare të UNICEF-it ose të pozicioneve të zyrtarëve të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Lexuesit inkurajohen të përdorin materiale nga ky raport për botimet e tyre. Si mbajtës i së drejtës së autorit, UNICEF-i në Shqipëri kërkon përmendjen e duhur dhe një kopje të botimit.

Citim i sugjeruar i raportit:

Davy, D., dhe Metanji, B. (2022) *“Anketa mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikën e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë: Vala e dytë. Përmbledhje e Gjetjeve për qarkun e Kukësit”* UNICEF-I Shqipëri dhe IDRA.

Për komente dhe sugjerime ju lutem shkruani në adresën elektronike tirana@unicef.org

Anketa mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë

Vala e dytë

Përmbledhje e gjetjeve për qarkun e Kukësit

Shtator 2022



TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	6
2. SYNIMI DHE OBJEKTIVAT	7
3. METODOLOGJIA	8
4. GJETJET	10
5. PËRFUNDIME	26

1. HYRJE

Shqipëria është një vend që është prekur ndjeshëm nga trafikimi i qenieve njerëzore dhe vazhdon të zhvillojë një gamë të gjerë politikash dhe mekanizmash për të luftuar këtë fenomen. Shqipëria njihet si vend burim për trafikimin e qenieve njerëzore. Shqiptarët trafikohen kryesisht në Itali, Greqi, Mbretërinë e Bashkuar, Suedi, Gjermani dhe Zvicër, shpesh përmes rrjeteve të organizuara kriminale. Trafikimi në familje në Shqipëri ka qenë një fenomen domethënës për rreth dy dekada, ku shumica e viktimave në familje janë fëmijë dhe të rinj. Shumica e viktimave shqiptare vijnë nga një historik varfërie, papunësie dhe mungesë arsimit. Për fëmijët dhe të rinjtë e trafikuar, faktorët e rrezikut rrjedhin kryesisht nga shtëpia dhe familja dhe përfshijnë shpërbërjen dhe braktisjen e familjes. Pasojat e këtyre faktorëve shoqërohen nga mungesa e rrjetet mbrojtëse dhe të sigurisë.

Pavarësisht dëshmimeve të qarta se të rinjtë shqiptarë janë të cenueshëm ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, ekziston një mungesë literature mbi nivelin e njohurive të të rinjve në lidhje me fenomenin në Shqipëri, apo për qëndrimet dhe praktikën e të rinjve në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore. Vetëm një studim i fundit (2016) diskuton njohuritë dhe ndërgjegjësimin për trafikimin e qenieve njerëzore në vend.¹ Ky studim tregon se të rriturit shqiptarë janë më të vetëdijshëm për trafikimin për seks sesa trafikimin për punës; se më shumë se gjysma e të rriturve shqiptarë të anketuar mendojnë se trafikimi i qenieve njerëzore është një problem serioz, por mendojnë se më së shumti ka të bëjë me gratë dhe fëmijët; dhe se shumë njerëz nuk e dinë se si mund t'i ndihmojnë viktimat e dëshpëruara.

Duke qenë se studimi nuk trajtoi në mënyrë specifike nivelin e njohurive të të rinjve, apo qëndrimet dhe praktikën e tyre në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, ky studim e analizon temën me synimin e mbushjes së hendeqeve të rëndësishme në njohuri. Rezultatet e studimit synojnë të jenë të dobishme për palët e interesuara qeveritare dhe joqeveritare që punojnë në fushën e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore.

Ky studim është një anketë e valës së dytë të njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve shqiptarë në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë, dhe romët. Ai është vazhdim i anketës së valës së parë, rezultatet e të cilës u botuan në dhjetor të vitit 2020². Kjo anketë e valës së dytë përsëriti pyetjet e anketës së valës së parë në masën maksimale të mundshme.

Ky raport përqendrohet vetëm në qarkun e Kukësit në Shqipëri, duke krahasuar rezultatet e anketës në Kukës me rezultatet në të katër qarqet e analizuar. Një raport i madh, i cili paraqet gjetjet e anketës, është botuar së bashku me katër raporte në nivel qarku dhe një raport për të rinjtë romë. Për analizë të mëtejshme, të dhënat e mbledhura nga anketa e valës së dytë mbahen dhe vizualizohen në një panel të posaçëm.³

Prezantimi i rezultateve në nivel qarku është krijuar për të udhëhequr zhvillimin e përpjekjeve të komunikimit të trafikimit të qenieve njerëzore të përshtatura në kontekst. Në këtë raport nuk bëhet krahasimi ndërmjet rezultateve të anketës së valës së parë dhe asaj të dytë, pasi ndryshimet në njohuri, qëndrime dhe praktika ishin minimale. Duhet të theksohet më tej se aty ku të dhënat nuk diskutohen në kuadrin e tabelave apo figurave, kjo ndodh për shkak se ndryshimi nuk ishte i konsiderueshëm.

¹ USAID, 2016, Matja e opinionit publik mbi trafikimin e qenieve njerëzore në Moldavi dhe Shqipëri duke përdorur eksperimente të anketave për të informuar programet efektive të parandalimit dhe ndërgjegjësimin.

² ² Davy, D., dhe Metanj, B., 2020, [Anketë e valës së parë mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikën e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqe të Shqipërisë. Raport për gjetjet](#). UNICEF në Shqipëri dhe IDRA.

³ [Paneli i studimit](#)

2. SYNIMI DHE OBJEKTIVAT

Studimi synon të kuptojë dhe eksplorojë nivelin e njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve⁴ në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore në qarqet Dibër, Kukës, Shkodër dhe Tiranë, si dhe të rinjve romë. U përzgjedhën këto qarqe sepse ato janë rajone të njohura burimi për trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri dhe të shqiptarëve jashtë vendit.

Objektivat e studimit ishin matja e njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve të anketuar në fushat e mëposhtme.

Njohuritë

- Ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore
- Format e shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri dhe në vende të huaja
- Kush është në rrezik trafikimi të qenieve njerëzore
- Metodatat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore
- Mënyrat për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore
- Shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat

Qëndrimet

- Niveli i shqetësimit rreth trafikimit të qenieve njerëzore
- Qëndrimet ndaj viktimave

Praktikat

- Interesi për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore
- Interesi për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes së trafikimit të qenieve njerëzore

2.1 Rezultatet e strategjisë së komunikimit të UNICEF-it

- Ekspozimi ndaj materialeve të komunikimit të trafikimit të qenieve njerëzore gjatë dy viteve
- Rritja e njohurive, qëndrimeve dhe interesit për t'u angazhuar në aktivitete kundër trafikimit të qenieve njerëzore si rezultat i ekspozimit.

2.2 Struktura e raportit

Në vijim të këtij seksioni hyrës, raporti paraqet metodologjinë e studimit. Raporti më pas paraqet gjetjet e anketës së njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore. Raporti përfundon me një përmbledhje të shkurtër të pikave kryesore. Shtojca ofron një shpjegim të hollësishëm të metodologjisë së anketimit.

⁴ Moshë 15 deri në 29 vjeç, siç përcaktohet nga Komisioni Evropian. [Shih EUROSTAT, Rinia – vështrim i përgjithshëm.](#)

3. METODOLOGJIA

3.1 Qasja ndaj anketës

Përafërsisht 1400 të rinjtë e anketuar për këtë studim përfshinin të anketuar të moshës 15-29 vjeç që jetonin në Tiranë, Shkodër, Kukës dhe Dibër (përkatesisht 350 të anketuar). Mostra përfshinte një kampion për popullsinë rome, duke përfshirë 200 të rinj romë të anketuar.

Pjesëmarrësit e anketës u zgjedhën në mënyrë rastësore. Të dhënat zyrtare⁵ tregojnë se në total janë rreth 300 mijë persona të moshës 15-29 vjeç që jetojnë në vend në të katër qarqet e studimit. Kjo nënkupton që një kampioni prej 1600 të anketuarve garanton rezultate përfaqësuese në nivel kombëtar me një marzh gabimi 2.62 përqind me një interval besimi prej 95 përqind. Marzhi i gabimit në nivel qarku është 5.24 përqind me një interval besimi 95 përqind (shih Shtojcën e raportit për një pasqyrë të metodologjisë).

Anketa është realizuar përmes intervistave fizike ballë për ballë. Në intervistë u ftua të merrte pjesë vetëm një person për familje në grupmoshën 15-29 vjeç. Softueri u përdor për të zgjedhur rastësisht familjet.

Mbledhja e të dhënave është kryer gjatë periudhës 14 janar deri më 1 mars 2022 nga anketues të trajnuar të punësuar nga IDRA Research and Consulting. Secila intervistë zgjati afërsisht 20 minuta.

3.2 Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave u realizua nga IDRA duke përdorur paketën softuerike statistikore IBM SPSS 25. Të dhënat janë ponderuar në mënyrë që të jenë përfaqësuese për çdo qark dhe në total. Kjo është bërë në mënyrë që kontributi i të anketuarve nga çdo qark të jetë proporcional me shifrat e popullsisë sipas qarqeve. Rezultatet në këtë raport janë të ndara sipas treguesve kryesorë demografikë si mosha, gjinia dhe urbaniteti.

3.3 Aspekte etike

Pyetjet e anketës mbi trafikimin e qenieve njerëzore nuk ishin pyetje sfiduese apo delikate për të rinjtë e anketuar. Megjithatë, u krye një vlerësim etik, pasi të dhënat u mbledhën nga fëmijët e moshës 15-17 vjeç si dhe nga të rinjtë më të rritur (ata të moshës 18-29 vjeç). Përpara se të fillonte mbledhja e të dhënave, studimit mori miratimin etik nga Bordi i Kërkimeve Etike i Health Media Lab. Ltd.⁶

Për këtë studim, ekipi respektoi:

- Rregulloren për “Etikën e Veprimtarisë Kërkimore dhe Botuese”, dhe konkretisht nenin 1.1.4, i cili kërkon që institucionet “të ruajnë një klimë bashkëpunimi që promovon përgjegjësinë dhe etikën gjatë kërkimit”. Ky udhëzues (rregullore) është miratuar nga qeveria e Shqipërisë si dokument orientues mbi çështjet e etikës për kompanitë, institucionet dhe konsulentët që kryejnë kërkime.
- Procedurat e UNICEF-it për standardet etike për kërkimin, vlerësimin, mbledhjen dhe analizën e të dhënave (2021).

Tabela 1. Numri i anketave të kryera në secilin prej qarqeve të përzgjedhura

Qarku	Bashkitë	Anketat
Tirana	Kamza	233
	Paskuqan/ Babrru	117
Shkodër	Shkodër	350
Kukës	Kukës	177
	Has	70
	Tropojë	93
Dibër	Dibër	190
	Mat	156
Numri i përgjithshëm i të anketuarve në të katër qarqet		1.387
Romë	Romë	200
Numri i përgjithshëm i të anketuarve		1.587

⁵ Instituti i Statistikave të Shqipërisë: Rezultatet nga Censusi i vitit 2011; Linku është aksesuar për herë të fundit në korrik 2022: <http://www.instat.gov.al/en/themes/censuses/census-of-population-and-housing/#tab2>

⁶ Shih <https://www.healthmedialabirb.com/>

Ekipi kërkimor mbështeti standardet themelore të mëposhtme:

- që subjektet të mos vendoseshin në rrezik të panevojshëm;
- që pjesëmarrja të ishte vullnetare dhe subjekteve u sigurohet pëlqimi i informuar para pjesëmarrjes së tyre; dhe
- që të prezantohen protokolle me shkrim për të siguruar konfidencialitetin dhe anonimitetin e subjektit.

Gjatë mbledhjes së të dhënave, anketuesit u shpërndanë fletëpalosje pjesëmarrësve në anketë dhe familjet e tyre, duke përfshirë informacion mbi shërbimet mbështetëse për kujdesin mendor dhe psikologjik, dhe kanalet e raportimit për trafikimin e qenieve njerëzore

4. GJETJET

4.1 Profili i të rinjve të anketuar në Kukës

Nga 346 të anketuarit e rinj në Kukës, 44 përqind ishin femra dhe 56 përqind ishin meshkuj. Për sa i përket moshës, shumica e të rinjve të anketuar në Kukës (45%) ishin të moshës 18-24 vjeç. Tetëmbëdhjetë përqind ishin të moshës 15-17 vjeç dhe 37 përqind ishin të moshës 25-29 vjeç.

Figura 1. Të anketuarit sipas seksit






Figura 2. Të anketuarit sipas moshës



Për sa i përket urbanitetit, 60 përqind e të rinjve të anketuar në Kukës jetonin në zona rurale dhe 40 përqind jetonin në zona urbane.

Figura 3. Të anketuarit sipas urbanitetit




4.2 Gjetjet mbi njohuritë në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore

Njohuritë lidhur me ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore

Të dhënat e anketës tregojnë se shumica e të rinjve të anketuar në Kukës kanë njohuri se trafikimi i qenieve njerëzore të shtetasve shqiptarë ndodh në shtete të huaja (Figura 4). Megjithatë, të rinjtë e anketuar në Kukës kanë më pak njohuri se trafikimi ndodh brenda Shqipërisë dhe aq më pak se ai ndodh në komunitetin/zonën e tyre. Dyzet e gjashtë përqind e të rinjve të anketuar në Kukës mendojnë se trafikimi i qenieve njerëzore i shtetasve shqiptarë në shtetet e huaja ndodh në një masë shumë të madhe ose në një masë të madhe. Tridhjetë e katër përqind e të rinjve të anketuar në Kukës mendojnë se trafikimi i qenieve njerëzore i shtetasve shqiptarë ndodh në Shqipëri në një masë shumë të madhe ose të madhe. Vetëm shtatë përqind e të rinjve të anketuar në Kukës mendojnë se trafikimi i qenieve njerëzore ndodh brenda komunitetit/zonës së tyre në një masë shumë të madhe ose të madhe.


Figura 4. Njohuritë mbi trafikimin e qenieve njerëzore të shtetasve shqiptarë



Pyetje e anketës: Sipas njohurive tuaja, në çfarë mase ndodh trafikimi i qenieve njerëzore (të shtetasve shqiptarë) në shtetet e huaja, në Shqipëri dhe në komunitetin/zonën tuaj? Grafiku paraqet përqindjet vetëm për opsionet e përgjigjes: 'në një masë shumë të madhe' dhe 'në një masë të madhe'. **Popullsia e synuar:** Kukës, gjithsej katër qarqe

Ndërmjet të rinjve të anketuar në Kukës nuk ka diferenca domethënëse tek të rinjtë meshkuj dhe të rejtat femra mbi vendin ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore (figura 5).


Figura 5. Njohuritë mbi trafikimin e qenieve njerëzore të shtetasve shqiptarë sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjet vetëm për opsionet e përgjigjes: 'në një masë shumë të madhe' dhe 'në një masë të madhe'.
Popullsia e synuar: Kukës

Rezultatet sipas grupmoshave (figura 6) tregojnë se të rinjtë e anketuar të moshës 18-24 vjeç kanë njohuri më të larta se të rinjtë e tjerë të anketuar se ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore.


Figura 6. Njohuritë mbi trafikimin e qenieve njerëzore të shtetasve shqiptarë sipas grupmoshave



Grafiku paraqet përqindjet vetëm për opsionet e përgjigjes: 'në një masë shumë të madhe' dhe 'në një masë të madhe'.
Popullsia e synuar: Kukës

Njohuritë mbi trafikimin e qenieve njerëzore që ndodhin në Shqipëri dhe në shtetet e huaja janë dukshëm më të larta ndërmjet të rinjve të anketuar që jetojnë në zonat rurale (Figura 7). Pesëdhjetë e katër përqind e të rinjve të anketuar që jetojnë në zonat rurale mendojnë se trafikimi i qenieve njerëzore ndodh në një masë shumë të madhe ose të madhe në shtetet e huaja, krahasuar me vetëm 34 përqind të të rinjve të anketuar në zonat urbane. Gjithashtu, 38 përqind e të rinjve të anketuar në zonat rurale të Kukësit mendojnë se trafikimi i qenieve njerëzore në Shqipëri ndodh në një masë shumë të madhe ose të madhe, krahasuar me 28 përqind të të rinjve të anketuar në zonat urbane të Kukësit.

Figura 7. Njohuritë mbi trafikimin e qenieve njerëzore të shtetasve shqiptarë sipas urbanitetit



Grafiku paraqet përqindjet vetëm për opsionet e përgjigjes: 'në një masë shumë të madhe' dhe 'në një masë të madhe'.
Popullsia e synuar: Kukës

Format e shfrytëzimit të shqiptarëve në Shqipëri dhe jashtë vendit

Të rinjtë e anketuar në Kukës kanë njohuri dukshëm më të ulëta se popullsia totale e të anketuarve në të katër qarqet për disa forma shfrytëzimi që ndodhin në Shqipëri dhe në shtetet e huaja (Tabela 2). Në veçanti, njohuritë e të rinjve të anketuar në Kukës janë më të ulëta se popullsia totale e të anketuarve në të katër qarqet lidhur me martesën e detyruar, martesën e hershme dhe lypjen e detyruar të të rriturve dhe fëmijëve në Shqipëri dhe në shtetet e huaja.

Tabela 2. Njohuritë mbi format e shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri dhe në shtetet e huaja

	Në Shqipëri		Në shtetet e huaja	
	Totali në Kukës	Totali i katër qarqeve	Totali në Kukës	Totali i katër qarqeve
Shfrytëzimi seksual i të rriturve	81%	80%	69%	76%
Shfrytëzimi seksual i fëmijëve	79%	87%	59%	73%
Puna e detyruar e të rriturve	63%	70%	49%	67%
Puna e detyruar e fëmijëve	82%	83%	53%	70%
Martetat e detyruara	53%	67%	17%	56%
Martetat e hershme	61%	85%	21%	57%
Lypja e detyruar e të rriturve	42%	66%	24%	56%
Lypja e detyruar e fëmijëve	82%	93%	46%	76%
Kriminaliteti i detyruar i të rriturve	72%	81%	75%	81%
Kriminaliteti i detyruar i fëmijëve	71%	83%	71%	76%
N	341	1387	341	1387

Pyetja e anketës: Sipas njohurive tuaja, format e mëposhtme të shfrytëzimit që përfshijnë shtetas shqiptarë a ndodhin në Shqipëri dhe në shtete të huaja? Grafiku paraqet përqindjet vetëm për opsionin e përgjigjes "po". **Popullsia e synuar:** Kukës, gjithsej katër qarqe

Grupet në risk nga trafikimi i qenieve njerëzore

Rezultatet e anketës tregojnë se ka një perceptim të njëanshëm gjinor tek të rinjtë e anketuar në Kukës se cilat grupe njerëzish janë në rrezik të trafikimit të qenieve njerëzore (Tabela 3). Grupi i konsideruar nga të rinjtë e anketuar në Kukës si më të rrezikuarit për t'u trafikuar janë vajzat nën 18 vjeç. Gjashtëdhjetë e gjashtë përqind e të rinjve të anketuar në Kukës e konsiderojnë këtë grup si tepër shumë ose shumë të rrezikuar nga trafikimi. Të rinjtë e anketuar në Kukës mendojnë se grupi i dytë më i rrezikuar për t'u trafikuar janë djemtë nën 18 vjeç. Pesëdhjetë e dy përqind e të rinjve të anketuar në Kukës mendojnë se djemtë nën 18 vjeç janë tepër shumë ose shumë të rrezikuar nga trafikimi, krahasuar me vetëm 26 përqind të popullsisë së përgjithshme të anketimit në të katër qarqet. Vihet re më tej se 23 përqind e të rinjve të anketuar në Kukës mendojnë se meshkujt mbi 18 vjeç janë tepër shumë/shumë të rrezikuar nga trafikimi i qenieve njerëzore, krahasuar me vetëm 5 përqind për të gjithë popullsinë e anketuar në të katër qarqet. Nga ana tjetër, vetëm dhjetë përqind e të rinjve të anketuar në Kukës mendojnë se njerëzit nga zonat rurale janë tepër shumë/shumë të rrezikuar nga trafikimi, krahasuar me 30 përqind të popullsisë së përgjithshme të të anketuarve në të katër qarqet.

Tabela 3. Njohuritë mbi cilat grupe të popullsisë janë në rrezik trafikimi


	Total Kukës	Total four regions
Women (over 18 years)	31%	37%
Girls (under 18 years)	66%	77%
Men (over 18 years)	23%	5%
Boys (under 18 years)	52%	26%
National minorities	47%	47%
People from rural areas	10%	30%
N	341	1387

Pyetja e anketës: Sipas njohurive tuaja, sa mendoni se secili nga grupet e mëposhtme të popullsisë është tepër shumë/shumë i rrezikuar për t'u trafikuar? Grafiku paraqet përqindjet e të anketuarve sipas mendimit se grupe të veçanta janë tepër shumë/shumë në rrezik për t'u trafikuar. **Popullsia e synuar:** Kukës, gjithsej katër qarqe

Ka ndryshime në njohuritë e të anketuarve meshkuj dhe femra lidhur me personat që janë në rrezik trafikimi dhe nuk mund të bëhen komente përfundimtare se cili seks ka njohuri më të mira (Figura 8). Të rejtat femra të anketuara në Kukës kanë njohuri më të mira se të rinjtë meshkuj se pakicat kombëtare janë në rrezik trafikimi (55% krahasuar me 39%). Megjithatë, të rinjtë meshkuj të anketuar në Kukës kanë

njohuri më të mira se të rejtat femra të anketuara në lidhje me trafikimin e djemve nën moshën 18 vjeç (53% krahasuar me 50%) dhe personave nga zonat rurale (13% krahasuar me 7%).


Figura 8. Njohuritë mbi cilat grupet e popullsisë që janë në rrezik trafikimi, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjet e të anketuarve sipas mendimit se grupe të veçanta janë tepër shumë/shumë në rrezik për t'u trafikuar.
Popullsia e synuar: Kukës

Në përgjithësi, të rinjtë e anketuar të moshës 18-24 vjeç në Kukës kanë njohuri më të mira se kategoritë e tjera të moshave të të rinjve për grupet në rrezik të lartë për t'u trafikuar (Figura 9). Për shembull, 32 përqind e të rinjve të anketuar të moshës 18-24 vjeç kanë njohuri se burrat janë në rrezik të lartë për t'u trafikuar, krahasuar me vetëm 19 përqind të të rinjve të anketuar të moshës 15-17 vjeç dhe 16 përqind të të rinjve të anketuar të moshës 25-29 vjeç.


Figura 9. Njohuritë mbi cilat grupet e popullsisë që janë në rrezik trafikimi, sipas grupmoshave



Grafiku paraqet përqindjet e të anketuarve sipas mendimit se grupe të veçanta janë tepër shumë/shumë në rrezik për t'u trafikuar.
Popullsia e synuar: Kukës

Në përgjithësi, të rinjtë e anketuar në zonat rurale të Kukës kanë njohuri më të mira se të rinjtë në zonat urbane se kush është në rrezik trafikimi të qenieve njerëzore (Figura 10). Për shembull, 62 përqind e të rinjve të anketuar në zonat rurale të Kukës kanë njohuri se djemtë (nën 18 vjeç) janë në rrezik trafikimit, krahasuar me vetëm 35 përqind të të rinjve të anketuar në zonat urbane.

Figura 10. Njohuritë mbi cilat grupet e popullsisë që janë në rrezik trafikimi, sipas urbanitetit



Grafiku paraqet përqindjet e të anketuarve sipas mendimit se grupe të veçanta janë tepër shumë/shumë në rrezik për t'u trafikuar.
Popullsia e synuar: Kukës

Metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore

Për të matur njohuritë e të rinjve të anketuar në Kukës lidhur me metodat e rekrutimit dhe se kush mund të jetë trafikant i qenieve njerëzore, të rinjtë e anketuar u pyetën nëse janë dakord me disa deklaratat në lidhje me metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore. Rezultatet (Tabela 4) tregojnë se të rinjtë e anketuar në Kukës kanë njohuri mbi metodat e rekrutimit. Edhe pse nuk kanë **kanë ndërgjegjësim të ulët se anëtarët e familjes mund të jenë trafikantë të qenieve njerëzore, më shumë prej tyre e dinë këtë (67%) sesa të rinjtë në të katër qarqet (48).**


Tabela 4. Njohuritë mbi metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore

Metoda e rekrutimit	Totali në Kukës	Totali në katër qarqe
Trafikantët janë pjesë e rrjeteve të grupeve të organizuara	91%	90%
Interneti mund të përdoret për të rekrutuar viktimat	94%	94%
Miqtë mund të jenë trafikantë të qenieve njerëzore	93%	86%
Anëtarët e familjes mund të jenë trafikantë të qenieve njerëzore	67%	48%
I dashuri/e dashura mund të jetë trafikant i qenieve njerëzore	91%	85%
N	341	1387

Pyetja e anketës: Deri në çfarë mase jeni dakord/nuk jeni dakord me sa vijon? Grafiku paraqet përqindjet e të anketuarve që janë plotësisht/disi dakord me pohimet. **Popullsia e synuar:** Kukës, gjithsej katër qarqe

Nuk ka asnjë ndryshim domethënës midis të rinjve meshkuj dhe femra të anketuar në lidhje me njohuritë mbi metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore (Figura 11). Dallimi më i madh është lidhur me njohurinë se anëtarët e familjes mund të jenë trafikantë të qenieve njerëzore (70 përqind e të rejave femra krahasuar me 63 përqind të të rinjve meshkuj).


Figura 11. Njohuritë mbi metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjet e të anketuarve që janë plotësisht/disi dakord me pohimet. **Popullsia e synuar:** Kukës

Rezultatet sipas moshës tregojnë se të rinjtë e anketuar të moshës **18-24 vjeç kanë, në përgjithësi, njohuri më të larta se cilët mund të jenë trafikantë potencialë të qenieve njerëzore sesa grupmoshat e tjera të të rinjve** (Figura 12). Vetëm 53 përqind e të rinjve të anketuar të moshës 15-17 vjeç e dinë se anëtari i familjes mund të jetë trafikant i qenieve njerëzore, krahasuar me 70 përqind të të rinjve të anketuar të moshës 18-24 vjeç dhe 69 përqind të të rinjve të anketuar të moshës 25-29 vjeç.


Figura 12. Njohuritë mbi metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore, sipas grupmoshës



Grafiku paraqet përqindjet e të anketuarve që janë plotësisht/disi dakord me pohimet. **Popullsia e synuar:** Kukës

Të rinjtë e anketuar në zonat urbane kanë njohuri më të ulëta se të rinjtë në zonat rurale në lidhje me metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore (Figura 13), me përjashtim të njohurive lidhur me anëtarët e familjes si trafikantë të qenieve njerëzore (75% dhe 60% respektivisht).

Figura 13. Njohuritë mbi metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore, sipas urbanitetit




Grafiku paraqet përqindjet e të anketuarve që janë plotësisht/disi dakord me pohimet. **Popullsia e synuar:** Kukës

Mënyrat për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore

Të rinjtë e anketuar në Kukës kanë njohuri më të larta se popullsia e përgjithshme e anketuar në të katër qarqet në lidhje me shumicën e mënyrave për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore. Tetëdhjetë e gjashtë përqind e të rinjve të anketuar në Kukës e dinë se mund të raportojnë raste të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore në linjën telefonike të Policisë 129, krahasuar me 75 përqind të popullsisë së përgjithshme të anketuar në të katër qarqet. Për më tepër, 34 përqind e të rinjve të anketuar në Kukës e dinë se mund t'u raportojnë punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve trafikantët e dyshuar të qenieve njerëzore, krahasuar me vetëm 18 përqind të totalit të katër qarqeve (Figura 14).

Figura 14. Njohuri mbi mënyrat se si të raportohen rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore



Pyetja e anketës: Sipas njohurive tuaja, cili nga kanalet e mëposhtme mund të përdoret për të raportuar një rast të dyshuar të trafikimit të qenieve njerëzore? Me disa përgjigje. **Popullsia e synuar:** Kukës, gjithsej katër qarqe

Të rejtat femra të anketuara (46%) në Kukës kanë njohuri më të mira se të rinjtë meshkuj (23%) në lidhje me kanalet e raportimit për rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore (Tabela 5). Ka ndryshime lidhur me njohuritë mbi mënyrat për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore në të gjitha kategoritë e moshave dhe nuk mund të bëhen komente përfundimtare se cila grupmoshë ka njohuri më të mira se si të raportojnë rastet e dyshuara të trafikimit. Të rinjtë e anketuar të moshës 18-24 vjeç njohin më shumë kanale raportimi sesa kategoritë e tjera të të rinjve të anketuar. Të rinjtë e anketuar të moshës 18-24 vjeç kanë njohuri më të larta se ata mund t'i raportojnë rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore te punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve. Të rinjtë e anketuar të moshës 25-29 vjeç kanë njohuri më të larta sesa të rinjtë më të rinj se mund të raportojnë rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore te organizatat jofitimprurëse. Nga ana tjetër, të rinjtë e anketuar në zonat urbane kanë njohuri më të larta në lidhje me mënyrat e tjera të raportimit (66% e dinë se mund të raportojnë një rast të dyshuar të trafikimit të qenieve njerëzore tek mësuesit/psikologët ose profesionistët e tjerë në shkollë, krahasuar me vetëm 36% të të rinjve të anketuar në zonat rurale.

Tabela 5. Njohuritë mbi mënyrat për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore sipas seksit, grupmoshës dhe urbanitetit

Ku raportohet trafikimi	Gjinia		Grupmosha			Urbaniteti	
	F	M	15-17	18-24	25-29	Urban	Rural
Rajoni i Policisë	84%	83%	83%	86%	82%	76%	89%
Linja telefonike e policisë 129	87%	85%	84%	92%	81%	79%	91%
Mësuesi/psikologu, profesionistët e tjerë në shkollë	48%	48%	44%	47%	52%	66%	36%
Punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve	46%	23%	26%	42%	28%	40%	29%
Organizata joqeveritare	36%	18%	10%	25%	37%	38%	19%
Mjeku/infermiera	36%	14%	12%	26%	29%	39%	14%
Linja kombëtare për konsultimin e fëmijëve-ALO 116	9%	2%	7%	5%	5%	5%	6%
Linja kombëtare telefonike (116 006)	17%	9%	14%	12%	12%	8%	15%
Aplikacioni – “Merr në telefon, Raporto!”	9%	1%	0%	6%	6%	7%	3%
Profesionistë të tjerë në bashki/njësi administrative	18%	15%	10%	16%	20%	24%	11%
Askush sa më sipër	1%	2%	1%	1%	2%	3%	0%
Tjetër	0%	1%	0%	1%	1%	1%	0%
Refuzoj	1%	1%	0%	0%	2%	2%	0%
N	151	190	63	152	126	137	204

Popullsia e synuar: Kukës

Gjashtëdhjetë e katër përqind e të rinjve të anketuar në Kukës janë të vetëdijshëm për të paktën tri mënyra raportimi të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore, krahasuar me 49 përqind të popullsisë së përgjithshme të të anketuarve në të katër qarqet (Figura 15).

Figura 15. Njohuri mbi të paktën tri mënyra për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore



Popullsia e synuar: Kukës, gjithsej katër qarqe

Raportimi ballë për ballë është mënyra e preferuar e raportimit për të rinjtë e anketuar në Kukës (Tabela 6), por **më pak krahasuar me popullsinë e përgjithshme të anketimit** (64% dhe 72% respektivisht). **Të rinjtë e anketuar në Kukës preferojnë gjithashtu raportimin e një rasti të dyshuar të trafikimit të qenieve njerëzore përmes shërbimeve telefonike (Hotline, Helpline) (52%) dhe raportimin ballë për ballë tek institucionet jo ligjzbatuese (51%), krahasuar me popullsinë e përgjithshme të të anketuarve në të katër qarqet (përkatësisht 36% dhe 24%).**

Tabela 6. Kanalet e preferuara të raportimit të një rasti të trafikimit të qenieve njerëzore


Mënyrat e raportimit	Totali Kukës	Total i katër rajoneve
Zbatuesit e ligjit ballë për ballë (Policia, Prokuroria)	64%	72%
Shërbimet telefonike (Linja të dedikuara (Hotlines), linja ndihmëse (Helpline))	52%	36%
Raportimi ballë për ballë te institucionet jo ligjzbatuese	51%	24%
Një OJQ e specializuar për këtë çështje	23%	12%
Platformë me bazë në ueb/aplikacion celular	4%	9%
Asnjë nga më sipër	3%	4%
Refuzoj	1%	1%
N	341	1387

Pyetja e anketës: Cilin nga kanalet e mëposhtme të raportimit të një rasti të trafikimit të qenieve njerëzore do të konsideroni/preferoni të raportoni? Me disa përgjigje. **Popullsia e synuar:** Kukës, gjithsej katër qarqe

Shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore

Njohuritë e të rinjve të anketuar në Kukës në lidhje me shërbimet mbështetëse në dispozicion të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore janë më të larta se ndërmjet popullsisë së përgjithshme të të anketuarve (Figura 16), veçanërisht në lidhje me disponueshmërinë e këshillimit për të drejtat ligjore dhe shërbimet e disponueshme (36% dhe 11% respektivisht).

Figura 16. Njohuritë lidhur me mbështetjen e disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri



Pyetja e anketës: Sipas njohurive tuaja, cilat nga llojet e mëposhtme të mbështetjes janë të disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri? Me disa përgjigje. **Popullsia e synuar:** Kukës, gjithsej katër qarqe

Gjashtëdhjetë e pesë përqind e të rinjve në Kukës e njohin disponueshmërinë e mbështetjes nga Policia e Shtetit, krahasuar me 45 përqind të popullsisë së përgjithshme. Gjithsesi, **21 përqind prej tyre nuk kanë njohuri mbi shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat e trafikimit në Shqipëri.**

Ndërmjet të rinjve në Kukës, më shumë të reja femra sesa të rinj meshkuj kanë njohuri për llojet e mbështetjes për viktimat e trafikimit (Tabela 7), ndërsa të rinjtë e moshës 15-17 vjeç kanë më pak njohuri se grupmoshat e tjera. Të rinjtë e anketuar që jetojnë në zonat urbane kanë njohuri dukshëm më të larta, krahasuar me të rinjtë në zonat rurale, lidhur me mbështetjen e ofruar ndaj viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në zonat e mbështetjes për strehim; këshillim, mbështetje përmes linjave ndihmëse/linjave të dedikuara; akomodim në strehëza; mbështetje financiare; mbështetje për punësim; dhe shëndetësi. Megjithatë, të rinjtë në zonat rurale kanë njohuri më të mira se të rinjtë në zonat urbane në lidhje me mbështetjen specifike të ofruar nga Policia e Shtetit.


Tabela 7. Njohuritë mbi mbështetjen e disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri

Llojet e mbështetjes	Gjinia		Grupmosha			Urbaniteti	
	F	M	15-17	18-24	25-29	Zona urbane	Zona rurale
Mbështetje specifike nga Policia e Shtetit	70%	61%	65%	70%	59%	57%	70%
Mbështetje psikosociale (shëndeti mendor)	46%	23%	21%	37%	37%	39%	31%
Mbështetje sociale (duke përfshirë mbështetjen për riintegrim) nga qeveria	49%	30%	22%	40%	46%	43%	36%
Mbështetja sociale (duke përfshirë mbështetjen për riintegrimin) nga OJQ-të	35%	15%	10%	22%	35%	35%	18%
Mbështetje për strehim	36%	21%	18%	24%	39%	44%	18%
Këshillim, mbështetje përmes linjave të ndihmës/linjave telefonike të dedikuara	34%	15%	12%	21%	34%	37%	15%
Akomodimi në strehëza	46%	26%	16%	30%	52%	58%	20%
Mbështetje financiare	30%	23%	10%	21%	40%	49%	11%
Mbështetje për punësim	28%	13%	8%	18%	28%	35%	10%
Mbështetje mjekësore	35%	16%	8%	24%	35%	37%	17%
Këshillim rreth të drejtave ligjore dhe shërbimeve të disponueshme	42%	31%	24%	37%	41%	42%	32%
Mbështetje e dedikuar për trajnim/arsimim	26%	16%	8%	20%	30%	30%	15%
Nuk e di/Refuzoj	21%	22%	33%	18%	19%	17%	25%
N	151	190	63	152	126	137	204

Popullsia e synuar: Kukës

Më shumë se gjysma e të rinjve të anketuar në Kukës, (54%) janë në dijeni për të paktën tre lloje të mbështetjes për viktimat e trafikimit, krahasuar me 39 përqind të popullsisë së përgjithshme të të anketuarve në të katër qarqet (Figura 17).

Figura 17. Njohuritë mbi të paktën tri forma të mbështetjes së disponueshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri




Popullsia e synuar: Kukës, gjithsej katër qarqe

4.3 Qëndrimet lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore

Niveli i shqetësimit

Shqetësimi mbi trafikimin e qenieve njerëzore është më i ulët ndërmjet të rinjve të anketuar në Kukës (60% jashtëzakonisht shumë ose shumë, Figura 18).


Figura 18. Niveli i shqetësimit mbi trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri



Pyetja e anketës: Sa i shqetësuar jeni mbi trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri? **Popullsia e synuar:** Kukës, gjithsej katër qarqe

Të rinjtë meshkuj të anketuar në Kukës janë më pak të shqetësuar sesa të rejtat femra të anketuara lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri (Figura 19).


Figura 19. Niveli i shqetësimit mbi trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që ndihen jashtëzakonisht / shumë të shqetësuar. **Popullsia e synuar:** Kukës

Të rinjtë e anketuar të moshës 15-17 vjeç janë më pak të shqetësuar lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Kukës sesa grupmoshat e tjera (40% janë jashtëzakonisht ose shumë të shqetësuar, krahasuar me 64% të moshës 18-24 vjeç dhe 65% të moshës 25-29 vjeç, Figura 21).


Figura 20. Niveli i shqetësimit mbi trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas grupmoshave



Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që ndihen jashtëzakonisht / shumë të shqetësuar. **Popullsia e synuar:** Kukës

Ndërkohë në Kukës, të rinjtë në zonat urbane ndjejnë më shumë shqetësim sa i takon trafikimit të qenieve njerëzore sesa të rinjtë në zonat rurale (66% përkundjet 56% respektivisht; Figura 21).

Figura 21. Niveli i shqetësimit mbi trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, sipas urbanitetit



Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që ndihen jashtëzakonisht / shumë të shqetësuar. **Popullsia e synuar:** Kukës

Në përgjithësi, të rinjtë e anketuar në Kukës, raportuan që janë më shumë të shqetësuar për mungesën e zbatimit të ligjit dhe lidhjen me krimin e organizuar (Tabela 8).

Tabela 8. Fushat më të rëndësishme të shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore

Fushat e shqetësimit	Totali		Kukës						
			Gjinia		Grupmosha			Urbaniteti	
	Kukës	Katër qarqet	F	M	15-17	18-24	25-29	Zona urbane	Zona rurale
Mungesa e zbatimit të ligjit	76%	72%	82%	70%	69%	75%	79%	80%	73%
Rritje e trafikimit të fëmijëve/të rinjve	43%	63%	50%	36%	30%	49%	40%	34%	49%
Niveli i ulët i ndërgjegjësimit të popullatës për këtë fenomen	40%	47%	46%	34%	25%	41%	45%	43%	38%
Besueshmëria e ulët te institucionet përkatëse ku raportohen raste të tilla	43%	41%	52%	34%	30%	43%	48%	44%	42%
Mbështetje e pamjaftueshme për viktimat	43%	34%	48%	38%	31%	43%	47%	46%	41%
Rritja e trafikimit të të rriturve	35%	28%	36%	34%	39%	36%	32%	25%	41%
Lidhja midis krimit të organizuar dhe trafikimit të qenieve njerëzore	48%	28%	46%	49%	52%	50%	43%	42%	52%
Lidhja midis migracionit të paligjshëm dhe trafikimit të qenieve njerëzore	37%	17%	39%	35%	36%	43%	30%	29%	42%
Tjetër	0%	0%	1%	0%	0%	1%	0%	1%	0%
N	341	1387	151	190	63	152	126	137	204


Pyetja e anketës: Çfarë ju shqetëson kryesisht? Me disa përgjigje. **Popullsia e synuar:** Kukës, gjithsej katër qarqe

Të rejat femra të anketuara në Kukës janë më shumë të shqetësuara për mungesën e zbatimit të ligjit në krahasim me të rinjtë meshkuj të anketuar (përkatësisht 82% dhe 70%). Gjithashtu, të rejat femra të anketuara janë më shumë të shqetësuara sesa të rinjtë meshkuj të anketuar lidhur me besueshmërinë e ulët të institucionet përkatëse ku raportohen raste të tilla (përkatësisht 52% dhe 34%). Megjithatë, më shumë të rinj meshkuj sesa të reja femra janë të shqetësuar për lidhjen ndërmjet krimit të organizuar dhe trafikimit të qenieve njerëzore (përkatësisht 49% dhe 46%). Më shumë të rinj të anketuar që jetojnë në zonat rurale të Kukësit (41%) janë të shqetësuar për rritjen e trafikimit të të rriturve, sesa të rinjtë që jetojnë në zonat urbane (25%). Në mënyrë të ngjashme, të rinjtë e anketuar që jetojnë në zonat rurale të Kukësit (49%) janë më të shqetësuar për rritjen e trafikimit të fëmijëve dhe të rinjve, sesa të rinjtë e anketuar në zonat urbane (34%). Nga ana tjetër, më shumë të rinj që jetojnë në zona urbane (80%) janë të shqetësuar për mungesën e zbatimit të ligjit sesa të rinjtë në zonat rurale (73%).

Qëndrimet ndaj viktimave

Rezultatet tregojnë se të rinjtë e anketuar në Kukës (90%) besojnë fuqimisht se viktimave të trafikimit duhet t'u ofrohet mbështetje, njësoj si për të gjithë grupin e të anketuarve në të katër qarqet (90%; Figura 22).

Figura 22. Niveli i dakordësisë që viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe personat në rrezik trafikimi duhet të marrin mbështetje



Pyetja e anketës: Sa e përkrahni faktin që duhet t'u jepet mbështetje e veçantë viktimave të trafikimit apo atyre në rrezik trafikimi?
Popullsia e synuar: Kukës, gjithsej katër qarqe

Nëntëdhjetë e pesë përqind e të rejeve femra të anketuara në Kukës besojnë se viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore duhet t'u jepet mbështetje, krahasuar me 86 përqind të të rinjve meshkuj të anketuar në Kukës (Tabela 9). Në përgjithësi, të rinjtë e anketuar 18-24 vjeç kanë më shumë ndjeshmëri ndaj viktimave sesa grupmoshat e tjera të të rinjve (95% besojnë se viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore duhet t'u ofrohet mbështetje, krahasuar me 88% të të rinjve të moshës 15-17 vjeç dhe 86% të të rinjve të anketuar të moshës 25-29 vjeç). Ndërkohë, ka më pak ndjeshmëri për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në zonat urbane sesa në zonat rurale (82% përkundjet 96% respektivisht).

Tabela 9. Niveli i dakordësisë që viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore dhe personave në rrezik trafikimi duhet t'u ofrohet mbështetje, sipas gjinisë, grupmoshës, urbanitetit

Niveli i dakordësisë	Gjinia		Grupmosha			Urbaniteti	
	F	M	15-17	18-24	25-29	Zonat urbane	Zonat rurale
Jashtëzakonisht shumë/shumë	95%	86%	88%	95%	86%	82%	96%
Mesatarisht	1%	8%	6%	4%	6%	8%	3%
Pak/aspak	1%	2%	3%	0%	2%	3%	0%
Nuk e di/Refuzoj	3%	4%	3%	1%	6%	7%	1%
N	151	190	63	152	126	137	204

Popullsia e synuar: Kukësi

4.4 Gjetjet mbi praktikat


Interesi për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore

Të rinjtë e anketuar në Kukës kanë më pak interes për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore sesa popullsia totale e anketuar në të katër qarqet si në Figurën 23. Vetëm 29 përqind e të rinjve të anketuar në Kukës janë shumë të interesuar të mësojnë rreth mënyrave për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore, krahasuar me 39 përqind të popullsisë së përgjithshme të të anketuarve në të katër qarqet. Dhe vetëm 32 përqind e të rinjve të anketuar në Kukës janë shumë të interesuar të

mësojnë se ku mund të shkojnë për të marrë mbështetje viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, krahasuar me 43 përqind të popullsisë së përgjithshme të të anketuarve në të katër qarqet.

Të rinjtë e anketuar në Kukës janë më të interesuar (32%) të mësojnë se ku mund të shkojnë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për të marrë ndihmë/mbështetje.


Figura 23. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore



Pyetja e anketës: Deri në çfarë mase jeni të interesuar të dini rreth këtyre aktiviteteve? **Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë të interesuar. Popullsia e synuar:** Kukës, gjithsej katër qarqe

Të anketuarat femra në Kukës kanë më shumë interes për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore sesa të rinjtë meshkuj të anketuar (Figura 24). Për shembull, 34 përqind e të rejave femra janë të interesuara të mësojnë se si të raportojnë rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore, krahasuar me 24 përqind të të rinjve meshkuj.

Figura 24. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sipas seksit



Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë të interesuar. Popullsia e synuar: Kukës

Të rinjtë në Kukës të moshave 15-17 vjeç janë më pak të interesuar të mësojnë rreth trafikimit të qenieve njerëzore sesa të rinjtë më të mëdhenj në moshë (Tabela 10). Për shembull, vetëm 11 përqind e të rinjve të kësaj moshe janë të interesuar të mësojnë mbi metodat e rekrutimit, krahasuar me 31 përqind të të rinjve të moshës 18-24 vjeç dhe 38 përqind të të rinjve të moshës 25-29 vjeç.


Tabela 10. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sipas grupmoshave

Çështje te trafikimit të qenieve njerëzore	Grupmosha		
	15-17 vjeç	18-24 vjeç	25-29 vjeç
Kush është në rrezik trafikimi	15%	30%	34%
Format e ndryshme të shfrytëzimit	20%	27%	35%
Kush mund të jetë trafikant/profili i trafikantëve	17%	30%	38%
Metodat/taktikat e rekrutimit të viktimave	11%	31%	38%
Mënyrat për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore	16%	29%	35%
Ku mund të shkojnë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për të marrë ndihmë/mbështetje	22%	33%	37%
N	63	152	126

Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë të interesuar. Popullsia e synuar: Kukës

Të rinjtë e anketuar në zonat urbane të Kukësit janë dukshëm më të interesuar për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore sesa të rinjtë e anketuar në zonat rurale (Figura 25). Për shembull, 40 përqind e të rinjve të anketuar në zonat urbane janë të interesuar të mësojnë se kush mund të jetë trafikant/profili i trafikantëve, krahasuar me vetëm 24 përqind të të rinjve në zonat rurale.

Figura 25. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore, sipas urbanitetit



Grafiku paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë të interesuar. **Popullsia e synuar:** Kukës

Interesi për t'u përfshirë në aktivitetet për parandalimin dhe mbrojtjen e trafikimit të qenieve njerëzore

Të rinjtë e anketuar në Kukës janë më pak të interesuar që të angazhohen në aktivitetet për parandalimin dhe mbrojtjen e trafikimit të qenieve njerëzore në krahasim me popullsinë e përgjithshme të të anketuarve në të katër qarqet. Të rinjtë e anketuar në Kukës janë më të interesuarit për të informuar familjen/miqtë e tyre për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore (60%) dhe për të ofruar ndihmë/mbështetje për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit (52%). Të rinjtë e anketuar në Kukës janë më pak të interesuar për të mbështetur mbledhjen e fondeve për programet antitrafik (39%).

Tabela 11. Niveli i interesit për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore dhe aktiviteteve mbrojtëse

Aktivitete për parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i qenieve njerëzore	Totali Kukës	Total katër qarqet
Ofroj ndihmë/mbështetje për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit	52%	59%
Angazhohem në bisedime ose aktivitete kundër trafikimit në shkollë ose komunitet	51%	55%
Informoj familjen/miqtë e mi për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore	60%	61%
Dal vullnetar për punën kundër trafikimit të një OJQ	40%	39%
Mbështes mbledhjen e fondeve për programet kundër trafikimit	39%	40%
Raportoju diku për një viktimit të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore	43%	59%
Raportoju diku për një trafikant të dyshuar të qenieve njerëzore	40%	57%
N	341	1387

Pyetja e anketës: Sa i interesuar do të ishit të bënit sa më poshtë? Tabela paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë/disi të interesuar. **Popullsia e synuar:** Kukës, gjithsej katër qarqe

Nuk ka ndonjë ndryshim domethënës në nivelin e interesimit të të rinjve meshkuj dhe femra të anketuar për t'u angazhuar në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes nga trafikimi i qenieve njerëzore (Figura 26). **Të rejtat femra të anketuara (44%) janë më të interesuara për t'u përfshirë në punë vullnetare për punën antitrafik të një OJQ-je sesa të rinjtë meshkuj (36%).** Nga ana tjetër, **të rinjtë meshkuj të anketuar (61%) janë më të interesuar të informojnë familjen/miqtë e tyre për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore, sesa të rejtat femra (58%).**

Figura 26. Niveli i interesit për t'u angazhuar në aktivitete për parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i qenieve njerëzore, sipas seksit




Tabela paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë/disi të interesuar. **Popullsia e synuar:** Kukës

Të rinjtë e moshës 25-29 vjeç janë më të interesuar të angazhohen në shumicën e aktiviteteve që lidhen me parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave sesa të rinjtë e tjerë të anketuar (Tabela 12).

Tabela 12. Niveli i interesit për t'u angazhuar në aktivitete për parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i qenieve njerëzore, sipas grupmoshave

Aktivitete për parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i qenieve njerëzore	Grupmoshat		
	15-17 vjeç	18-24 vjeç	25-29 vjeç
Ofroj ndihmë/mbështetje për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit	50%	49%	55%
Angazhohem në bisedime ose aktivitete kundër trafikimit në shkollë ose komunitet	47%	52%	51%
Informoj familjen/miq të e mi për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore	61%	62%	57%
Dal vullnetar për punën kundër trafikimit të një OJQ	34%	39%	44%
Mbështes mblidhjen e fondeve për programet kundër trafikimit	31%	39%	42%
Raportoju diku për një viktimitë të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore	36%	44%	46%
Raportoju diku për një trafikant të dyshuar të qenieve njerëzore	37%	37%	44%
N	63	152	126

Tabela paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë/disi të interesuar. **Popullsia e synuar:** Kukës

Të rinjtë në zonat urbane të Kukësit janë më të interesuar që të përfshihen në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes ndaj trafikimit të qenieve njerëzore sesa të rinjtë e zonave rurale (Figura 27), përveç informimit të familjes/miqve të tyre për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore. Dallimi më i madh është në punën vullnetare antitrafik në një OJQ (53 dhe 32% respektivisht, janë shumë ose disi të interesuar për të bërë vullnetare).

Figura 27. Niveli i interesit për t'u angazhuar në aktivitete për parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i qenieve njerëzore, sipas urbanitetit




Tabela paraqet përqindjen e të anketuarve që janë shumë/disi të interesuar. **Popullsia e synuar:** Kukës

4.5 Gjetjet mbi rezultatet e strategjisë së komunikimit të UNICEF-it

Përafërsisht 39 përqind (N=132) e të rinjve të anketuar në Kukës raportuan se janë ekspozuar ndaj materialeve të komunikimit mbi trafikimin e qenieve njerëzore gjatë dy viteve të fundit.⁷ Nga të rinjtë e anketuar në Kukës që raportuan se ishin ekspozuar ndaj materialeve të komunikimit mbi trafikimin e qenieve njerëzore, 71 përqind e të rinjve të anketuar ishin ekspozuar ndaj materialeve të tilla nëpërmjet programeve televizive; 48 përqind përmes Facebook-ut; 48 përqind përmes Instagramit, 38 përqind përmes Tik Tok-ut; 31 përqind përmes YouTube; dhe 29 përqind përmes bisedave në shkollë (Figura 28).


Figura 28. Kanalet e ekspozimit ndaj materialeve të komunikimit mbi trafikimin e qenieve njerëzore



Pyetja e anketës: Përmes cilit nga kanalet e mëposhtme të komunikimit keni dëgjuar për ngjarjet, mesazhet apo materialet e komunikimit mbi temën e trafikimit të qenieve njerëzore? **Me disa përgjigje. Popullata e synuar:** Të rinjtë e anketuar që janë ekspozuar gjatë dy viteve të fundit ndaj çdo ngjarjeje, mesazhi apo materiali komunikimi mbi temën e trafikimit të qenieve njerëzore, Kukës.

Nga të rinjtë e anketuar në Kukës që raportuan se ishin ekspozuar ndaj materialeve të trafikimit të qenieve njerëzore gjatë dy viteve të fundit, **97 përqind raportuan se njohuritë e tyre në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore u rritën si rezultat i ekspozimit** (25% në një masë shumë të madhe; 52% në një masë e madhe; 20% deri diku; Figura 29).

Figura 29. Në çfarë mase janë përmirësuar njohuritë mbi trafikimin e qenieve njerëzore pas ekspozimit ndaj materialeve të komunikimit




Pyetja e anketës: Si rezultat i ekspozimit ndaj ngjarjeve, mesazheve ose materialeve të komunikimit, në çfarë mase janë përmirësuar njohuritë tuaja rreth trafikimit të qenieve njerëzore. **Popullata e synuar:** Të rinjtë e anketuar që janë ekspozuar gjatë dy viteve të fundit ndaj çdo ngjarjeje, mesazhi apo materiali komunikimi mbi temën e trafikimit të qenieve njerëzore, Kukës

Për më tepër, 95 përqind e të rinjve që u ekspozuan ndaj materialeve të trafikimit të qenieve njerëzore gjatë dy viteve të fundit deklaruan se kanë përmirësuar qëndrimet e tyre në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore dhe tani janë të interesuar të luajnë një rol më aktiv në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore (23% deri në masë shumë të madhe; 51% në një masë të madhe; 21% në një farë mase; Figura 30).

⁷ Kjo i referohet punës së bërë nga UNICEF Shqipëri dhe partnerët e saj, në kuadër të Programit *Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria*, nga prilli i vitit 2020 deri në kohën e intervistave të anketës.

Figura 30. Në çfarë mase ka ndryshuar qëndrimi pas ekspozimit ndaj materialeve mbi trafikimin e qenieve njerëzore



Pyetja e anketës: Si rezultat i ekspozimit ndaj ngjarjeve, mesazheve apo materialeve të komunikimit, deri në çfarë mase ka ndryshuar qëndrimi juaj për të luajtur një rol më aktiv në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore? **Popullata e synuar:** Të rinjtë e anketuar që janë ekspozuar gjatë dy viteve të fundit ndaj çdo ngjarjeje, mesazhi apo materiali komunikimi mbi temën e trafikimit të qenieve njerëzore, Kukës.

5. PËRFUNDIME

Ky raport, i cili paraqet gjetjet kryesore nga anketa e valës së dytë, ofron informacion të vlefshëm për njohuritë, qëndrimet dhe praktikave të rinjve të anketuar në Kukës në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore. Këto gjetje do të jenë me interes për subjektet kundër trafikimit që punojnë në fushën e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe në mbrojtjen e viktimave.

Për sa i përket rezultateve të njohurive, të dhënat e anketës tregojnë se shumica e të rinjve të anketuar në Kukës kanë njohuri se trafikimi i shtetasve shqiptarë ndodh në shtete të huaja, por kanë më pak njohuri se trafikimi ndodh brenda Shqipërisë dhe akoma më pak se ai ndodh në komunitetin/zonën e tyre lokale. Të rinjtë meshkuj të anketuar në Kukës kanë njohuri më të mira se të rejat femra se ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore. Njohuritë se ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore janë më të larta ndërmjet të rinjve të anketuar të moshës 18-24 vjeç dhe ndërmjet të rinjve që jetojnë në zonat rurale të Kukësit. Të rinjtë e anketuar në Kukës kanë njohuri dukshëm më të ulëta se popullsia e përgjithshme e të anketuarve në të katër qarqet mbi format e shfrytëzimit që ndodhin në Shqipëri dhe në shtete të huaja, veçanërisht në lidhje me martesën e detyruar, martesën e hershme dhe lypjen e detyruar të të rriturve dhe fëmijëve në Shqipëri dhe në shtete të huaja. Shumica e të rinjve të anketuar në Kukës kanë njohuri të pakta se grupe të tjera përveç vajzave dhe djemve (nën 18 vjeç) mund të jenë viktimat e trafikimit. Të rejat femra të anketuara, të rinjtë e moshës 18-24 vjeç dhe të rinjtë në zonat rurale të Kukësit kanë njohuri më të larta se të rinjtë e tjerë të anketuar në Kukës mbi personat që janë në rrezik të trafikimit të qenieve njerëzore. Të rinjtë e anketuar në Kukës kanë njohuri mbi metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore; megjithatë, të rinjtë e anketuar në Kukës kanë njohuri të ulëta se anëtarët e familjes mund të jenë trafikantë të qenieve njerëzore. Nuk ka ndonjë ndryshim domethënës sa i takon njohurive për metodat e rekrutimit dhe trafikantët e qenieve njerëzore midis të rinjve meshkuj dhe femra të anketuar, si dhe ndërmjet kategorive të moshës; megjithatë, njohja e metodave të rekrutimit për trafikim të qenieve njerëzore dhe trafikantëve të qenieve njerëzore është më e lartë ndërmjet të rinjve të anketuar në zonat rurale të Kukësit.

Krahasuar me numrin e përgjithshëm të popullsisë së anketuar në të katër qarqet, të rinjtë e anketuar në Kukës kanë njohuri të larta për mënyrat e raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore. Të rinjtë e anketuar të moshës 18-24 vjeç kanë njohuri më të mira për mënyrat për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore sesa të rinjtë e tjerë të anketuar.

Krahasuar me numrin e përgjithshëm të popullsisë së anketuar në të katër qarqet, të rinjtë e anketuar në Kukës kanë gjithashtu njohuri të larta në lidhje me shërbimet mbështetëse që ofrohen për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Megjithatë, gati një e katërta e të rinjve të anketuar në Kukës nuk janë në dijeni të ndonjë lloji mbështetjeje për viktimat e trafikimit në Shqipëri. Njohuritë për shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat janë më të larta ndërmjet të rejave femra të anketuara, të rinjve më të mëdhenj në moshë të anketuar dhe të rinjve në zonat urbane të Kukësit.

Për sa i përket qëndrimeve në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, shqetësimi për trafikimin e qenieve njerëzore tek të rinjtë e anketuar në Kukës është i ulët kur krahasohet me numrin e përgjithshëm të popullsisë së anketuar në të katër qarqet. Shqetësimi në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore është më i lartë ndërmjet të rejave femra të anketuara, të rinjve më të mëdhenj të anketuar dhe të rinjve në zonat urbane.

Qëndrimet e të rinjve të anketuar në Kukës ndaj viktimave janë pozitive, ku 93 përqind e të rinjve të anketuar raportojnë se viktimave duhet t'u ofrohet mbështetje. Të rejat femra të anketuara, të rinjtë e anketuar të moshës 18-24 vjeç dhe të rinjtë në zonat rurale të Kukësit kanë më shumë ndjeshmëri ndaj viktimave dhe ndjejnë më fort se të rinjtë e tjerë të anketuar se viktimave duhet t'u ofrohet mbështetje.

Për sa i përket praktikave, të rinjtë e anketuar në Kukës kanë më pak interes për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore sesa popullsia e përgjithshme e anketuar në të katër qarqet. Të rinjtë e anketuar në Kukës janë më të interesuarit për të mësuar se ku mund të shkojnë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për të marrë ndihmë/mbështetje. Interesi për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore është më i lartë ndërmjet të rejave femra të anketuara, të rinjve më të mëdhenj në moshë (d.m.th. ata të moshës 25-29 vjeç) dhe ndërmjet të rinjve në zonat urbane. Të rinjtë e anketuar në Kukës janë gjithashtu më pak të interesuar për t'u përfshirë në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes së trafikimit të qenieve

njerëzore sesa popullsia e përgjithshme e të anketuarve në të katër qarqet. Të rejtat femra të anketuara, të rinjtë e moshës 15-24 vjeç dhe të rinjtë në zonat urbane janë më të interesuar të përfshihen në aktivitetet e parandalimit dhe mbrojtjes së trafikimit sesa të rinjtë e tjerë të anketuar në Kukës.

Së fundi, për sa i përket rezultateve të strategjisë së komunikimit, 36 përqind e të rinjve të anketuar (n=132) në Kukës raportuan se ishin ekspozuar ndaj materialeve të komunikimit të trafikimit të qenieve njerëzore në dy vitet e mëparshme. Pothuajse të gjithë (97%) ata që raportuan se ishin ekspozuar raportuan gjithashtu rritje të njohurive në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore. Çfarë është e rëndësishme, 95 përqind e atyre që janë ekspozuar ndaj materialeve të komunikimit raportuan qëndrime të përmirësuara në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore dhe rritje të interesit për të luajtur një rol më aktiv në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Këto rezultate sugjerojnë që subjektet antitrafik duhet të përqendrojnë përpjekjet e tyre te përmirësimi i njohurive, qëndrimeve dhe praktikave në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore ndërmjet të rinjve meshkuj të të gjitha grupmoshave dhe të rinjve në zonat rurale të Kukësit. Vëmendje duhet t'i kushtohet veçanërisht forcimit të njohurive të të rinjve në Kukës mbi: praninë e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri dhe në Kukës; që burrat, gratë dhe të rinjtë në zonat rurale janë në rrezik trafikimi të qenieve njerëzore; që anëtarët e familjes mund të jenë trafikantë të qenieve njerëzore; mënyrat e raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore te subjekte të tjera përveç Policisë; dhe të shërbimeve mbështetëse që janë në dispozicion për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Programet parandaluese mund të synojnë gjithashtu përmirësimin e qëndrimeve të të rinjve në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore. Programet e ardhshme arsimore mund të përdorin metoda komunikimi që janë të njohura ndërmjet të rinjve të anketuar në Kukës, përkatësisht televizionin, mediat sociale dhe bisedat në shkollë.

